



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E**  
**TË DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 2379/6 prot.

Tiranë, më 27.12.2024

**REKOMANDIM**

**Nr. 42, datë 27.12.2024**

**PËR KONTROLLUESIN “MOVENPICK HOTEL”**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim “*Ligji*”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim “*Kodi i Procedurave Administrative*”), procesverbalit të hetimit administrativ si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “*Movenpick Hotel*”, (në vijim “*Kontrolluesi ose Movenpick Hotel*”),

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 195, datë 08.11.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “*Komisioneri*”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Movenpick Hotel/SPV Lura Hotel Shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar me numër identifikimi M119145070, i cili ka si objekt të aktivitetit të tij, ndër të tjera, aktivitet në fushën e turizmit, hapjen dhe menaxhimin e hoteleve, godinave dhe ambjenteve në të cilat ushtrohet aktiviteti hotelier. Menaxhim i sallave të konferencave në kuadër të aktivitetit hotelier. Menaxhim i qendrave të rekreacionit, me ose pa profil të dermo-estetikës, trajtimit të lëkurës dhe trupit, për masazhe, spa, mirëmbajtje trupore, fitness dhe pishina.

Kontrolluesi në kuadër të veprimtarisë që ushtron, përpunon të dhëna personale për kategoritë “klientë”, “punëmarrës”, “furnizues”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi disponon një sistem të video-survejjimit (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të jashtme dhe të brendshme. Nga verifikimi i kryer në vend konstatohet se, Kontrolluesi nuk disponon tabelë informimi për mbikëqyrjen e ambienteve me sistemin CCTV, në kundërshtim me parashikimin e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar (në vijim “Udhëzimi nr. 3”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbyshja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi duhet të parashikoj rregulla/politika dhe të marrë masa teknike-organizative, në mënyrë që të mbrohen sistemet e regjistrimit, mënyrat e transferimit dhe mjetet transmetuese në të cilin gjenden regjistrimet duke i mbrojtur nga aksesimi i paautorizuar apo aksidental, ndryshimi, shkatërrimi, humbja ose përpunimi i paautorizuar.

3. Konstatohet se Kontrolluesi nuk ka publikuar “Politikat e Privatësisë” në faqen zyrtare të internetit <https://adriatikhotel.com>. Subjektet e të dhënave nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (për akses, korrigjim dhe fshirje), etj, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, publikimi i rubrikës “Politikat e Privatësisë” në faqen zyrtare të Kontrolluesit përmbush qëllimin e informimit përkundrejt subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë faqen e internetit të Kontrolluesit. Njëkohësisht, informimi sipas përcaktimeve të nenit 18 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

4. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit rezulton se, Kontrolluesi nuk ka “Njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës.

Pas fillimit të hetimit administrativ, Kontrolluesi vendosi në dispozicion të grupit të hetimit administrativ “Formularin e Njoftimit”. Megjithatë, konstatohet se “Njoftimi” ka mangësi në deklaram, sa i përket rubrikave të formularit si vijon:

- i. Deklarimin në rubrikën 3, të formularit të njoftimit “Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen”, të tilla si: “Punëmarrës”; “Furnizues” etj.;
- ii. Deklarimin në rubrikën 4, të formularit të njoftimit “Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen”, të tilla si: “të dhënat e identifikimit”; “Numri i sigurimit shoqëror”; “Numri personal i identifikimit” etj.;
- iii. Deklarimin në rubrikën 6, të formularit të njoftimit “Qëllimi i përpunimit”, të tilla si: “Menaxhim i burimeve njerëzore”; “Mbikëqyrje të ambienteve nëpërmjet kamerave vëzhgim-regjistrimi” etj.
- iv. Deklarimin në rubrikën 9, të formularit të njoftimit “Mjetet për përpunimin e të dhënave personale”, të tilla si: “Instrumente elektronike”.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për “Njoftim” mbi përpunimin e të dhënave personale, sikurse edhe përditësimet e vazhdueshme të gjendjes së përpunimit, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre, sipas Ligjit.

5. Kontrolluesi vendosi në dispozicion të grupit të inspektimit rregullor të posacme për mbrojtjen e të dhënave personale në gjuhën angleze “Customer Personal Data Protection Charter”. Nga analizimi i të cilës rezulton se, është rregullor e hartuar nga “AccorHotels Group” që përfshin një grup ndërkombëtar i cili operon në fushën e turzimit, pjesë e të cilit është dhe Kontrolluesi.

Megjithatë, nga analizimi i rregullores rezulton se ajo nuk parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj., sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Kjo Rregullore duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale.

6. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”, (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”) për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që Kontrolluesi ushtron.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe në zbatim të nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

7. Kontrolluesi nuk aplikon për punëmarrësit “*Deklaratën e Konfidencialitetit*”, në përmbushje të detyrimit ligjor që buron nga neni 28 i Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete për hartimin dhe nënshkrimin e “*Deklaratës së Konfidencialitetit*” për çdo punonjës, të cilët detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë, gjatë dhe pas përfundimit të funksionit, në përmbushje të detyrimit ligjor që buron nga neni 28 i Ligjit dhe pikën 6 të Vendimit nr. 6 të Komisionerit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore datë 20.12.2024, të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar.

- Formular “*Njoftimi*”;
- Procesverbal i Hetimit Administrativ i firmosur;
- Autorizim për pjesëmarrjen në seancën dëgjimore Arbëri Bitincka, Fiona Laçi, Redi Doda;

- Tabelë mbi pjesëmarrjen në trajnim mbi njohjen dhe zbatimin e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008;
- QKB;
- Autorizim mbi aksesin e rrejtit të hotelit, sistemin e kamerave, sistemin e hotelit, kod aksesit për punonjës të Rei Doda;
- Rregullore mbi ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale për departamentin e Shitjeve dhe Rezervimeve;
- Rregullore mbi sistemet kompjuterike dhe sigurinë;
- Rregullore mbi ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale për Sallën e Konferencave;
- Rregullore mbi ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale për departamentin e SPA & Wellness;
- Rregullore mbi ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale për departamentin e Financës;
- Deklaratë konfidencialiteti;
- Kontratë/autorizim për periudhën janar – dhjetor 2024 të sportelit të përbashkët të agjencive të administrimit kolektiv;
- Tabela e informimit për sistemin e video-survejjimit CCTV;

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 5, 18, 21, 22, 27, 28, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesit, të kenë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kreun II të Ligjit;
2. Kontrolluesit, të marrin masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
3. Kontrolluesit, të marrin masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;

4. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të kryej përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës;
5. Kontrolluesit, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të marrin masa për të hartuar Rregullore specifike “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
6. Kontrolluesit, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të aplikojnë “Deklaratën e konfidencialitetit” me punëmarrësit të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale;
7. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
  - (i) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikat 1, 3 dhe 4 më sipër;
  - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 2 më sipër;
  - (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 5 dhe 6 më sipër;Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;
8. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
9. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 27.12.2024.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**